

Demensi i enëve të gjakut (Demensi vaskular)

FLETUSHKA FAKTIKE NGA QENDRA SUEDEZE PËR DEMENS

Vaskulär demenssjukdom • faktablad på albanska

Lëndimet në enët e gjakut

Demens është emër i perbashkët për një varg simptomash, që vështirësojnë të menduarit, planifikimin dhe komunikimin. Simptomat shkaktohen nga dëmtimet dhe sëmundjet e ndryshme në tru. Në rastin e demensit të enëve të gjakut, të ashtuquajtur demens vaskular, ka të bëjë me lëndime dhe ndryshime shkatërruese në enët e gjakut në tru dhe për këtë arsye nganjëherë quhet demens i enëve të gjakut.

Sëmundja e demensit vaskular është e dyta për nga numri i të prekurve nga sëmundja e demensit. Në bazë të të dhënave, 25–30% e të sëmurëve nga demensi, janë me demens vaskular. Në moshën e thyer, nuk është e rrallë, që sëmundja të paraqitet së bashku me sëmundjen e Alzheimerit, që është në vend të parë përse u përket sëmundjeve të demensit.

Goditja në tru (pika) është një faktor rreziku

Demensi vaskular mund të ketë shkaqe të ndryshme. Shpesh është shkak goditja në tru (pika) që do të thotë pllaka të gjakut, gjakderdhje në tru ose ngushtim dhe sklerozë në enët e gjakut. Në të gjitha rastet shkaktohet mungesa e oksigjenit në tru. Dëmtimet, që shkaktohen me këtë rast, mund të japin simptoma të cilat në mënyra të ndryshme mund të vështirësojnë përditshmërinë. Simptomat ndryshojnë nga personi në person, varësisht cila pjesë e trurit i është dëmtuar.

Simptomat ndryshojnë

Thjesht mund të konstatohet se rishikimi i situatave të ndryshme, kontrolli impulsiv dhe përqendrimi përkeqësohen, në qoftëse dëmtohet pjesa e përparme e trurit, pjesa frontale e kokës. Dëmtimet në pjesët anësore të trurit shkaktojnë harresën, vështirësi në komunikim dhe mësimin e gjërave të reja. Dëmtimet në pjesën më të thellë të trurit, në enët më të imta të gjakut, shkaktojnë lëvizje të ngadalësuara, vështirësi në planifikim, madje dhe për kryerjen e gjërave praktike.


Është me rëndësi të merret parasysh që stresi e rrit nivelin e simptomave.

Procesi i sëmundjes zhvillohet shkallë-shkallë

Sëmundja e demensit zakonisht lajmërohet fshehurazi dhe zhvillohet ngadalë. Por në rast të demensit të ashtuquajtur vaskular, simptomat shpesh lajmërohen papritmas dhe zhvillimi i sëmundjes mund të përshkruhet si shkallë-shkallë. Gjendja përkeqësohet, stabilizohet një kohë dhe sërish përkeqësohet.

Diagnostifikimi i hershëm është shumë i rëndësishëm

Demensi vaskular nuk mund të konstatohet vetëm me kontolle të thjeshta mjekësore. Diagnostifikimi bazohet nga një radhë testesh, kontrollesh mjekësore si dhe bisedë me pacientin dhe me familjarët. Diagnostifikimi i sëmundjes zakonisht merr katër deri gjashtë javë. Është me rëndësi që të fillohet sa më parë, që ndihma dhe trajtimi i përshtatshëm mund të jepen në kohën e duhur.



Parandalo dëmtimet e mëtejshme të enëve të gjakut

Nuk ekzistojnë barna që shërojnë sëmundjen e demensit vaskular. Trajtimi mjekësor synon parandalimin e dëmtimeve të tjera në tru. Barnat për hollimin e gjakut, jepen kur ekziston rreziku për tromb. Në shumë raste nevojitet rregullimi i tensionit të gjakut, nganjëherë me barna, pasi tensioni i lartë i gjakut është një faktor rreziku për goditje në tru. Gjithashtu diabeti duhet të mbahet nën kontroll, pasi kjo sëmundje mund të shkaktojë dëmtime në enët e imta të gjakut në tru.

Planifiko për një jetë sa më të mirë

Është me rëndësi të jepen sqarime rreth sëmundjes dhe simptomave, që të mund të planifikohet një jetë sa më e mirë dhe kuptimplotë. Përveq trajtimeve parandaluese, mjetet ndihmëse dhe një sërë ndihmash nga institucionet sociale dhe shëndetsore, lehtësojnë përditshmërinë.

30 janar 2016 • Svenskt Demenscentrum®

Më shumë informata në gjuhët e ndryshme mund ti lexoni në portalin Qendra Suedeze për demens:
www.demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Gävlegatan 16, 113 30 Stockholm, 08 - 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se